

VENDIM
Nr.1056, datë 22.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.269, DATË 5.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA
NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN – VLORË (SEKSIONI I PARË)”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.269, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në listën që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, disa prej pasurive, pronarëve dhe sipërfaqeve, sipas kolonës me emërtimin “Të dhënat e pasurive dhe pronarëve sipas saktësimeve të ZRPP-së”, ndryshojnë sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në pikën 3, ku përcaktohet sipërfaqja e përgjithshme, tokë arë, fjalët “... 253 036 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e gjashtë) m²...” zëvendësohen me “... 252 406 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e gjashtë) m²...”, dhe ku përcaktohet vlera e përgjithshme e shpronësimit, shifra “... 404 857 600 (katërqind e katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekësh ...” zëvendësohet me “... 403 849 600 (katërqind e tre milionë e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind) lekësh ...”.

2. Pronarëve të pasurive të paluajtshme, të cilat pësojnë ndryshime sipas kolonës me emërtimin “Të dhënat e pasurive dhe pronarëve sipas saktësimeve të ZRPP-së”, u takon masa e kompensimit, e paraqitur në këtë kolonë. Për ata pronarë, për të cilët nuk është bërë likuidimi për të gjithë sipërfaqen apo për një pjesë të saj dhe për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive, për të cilët në kolonën përkatëse është bërë shënimi “të pakonfirmuar”, “proces saktësimi”, “të pidentifikuar”, “shtet”, nëse nuk është bërë likuidimi i tyre, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë bërë regjistrimet apo pasi të ketë përfunduar procesi i saktësimit nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, dhe pasi të jenë konfirmuar të dhënat e plota dhe të sakta po nga kjo zyrë për titullin e pronësisë.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të marrë masat brenda kuadrit ligjor për përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, sipas të dhënave të pasqyruara në kolonën e emërtuar “Të dhënat e pasurive dhe pronarëve sipas saktësimeve të ZRPP-së”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve sipas pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

7. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit

që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Vendimi nr.823, datë 29.7.2009 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr.269, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan–Vlorë (seksioni i parë)”, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha